

V E N D I M
Nr.530, datë 17.10.1994

**PËR MËNYRËN E NDARJES SË APARTAMENTEVE TË NDËRTUARA NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Listat e qytetarëve që kanë statusin e të pastrehëve dhe që do të strehohen në banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, hartohen nga organet e pushtetit lokal nëpërmjet këshillave bashkiake ose këshillave të komunave, përkatësisht sipas vendndodhjes së banesës. Në përputhje me kërkesën e nenit 20 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", në hartimin e këtyre listave do të merret parasysh përbërja familjare dhe gjendja e strehimit deri në datën 1.12.1992.

2. Nuk përfitojnë nga statusi i të pastrehëve familje, pjesëtarët e të cilave kanë marrë truall për ndërtim banese që nga data 1.1.1991. Organet e pushtetit lokal hartojnë listat e këtyre qytetarëve të trajtuar me truall dhe i depozitojnë pranë degëve të Entit Kombëtar të Banesave.

3. Organet e pushtetit lokal kontrollojnë listat e plota të të pastrehëve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.49, datë 29.1.1993, të ndarë sipas kategorive përkatëse dhe të renditur për çdo kategori për të bërë korrigjimet e nevojshme në përputhje me gjendjen faktike të qytetarëve. Këto lista depozitohen pranë Entit Kombëtar të Banesave.

4. Ministria e Ndërtimit, Strehimit, dhe Rregullimit të Territorit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, dërgon pranë organeve të pushtetit lokal destinacionin e banesave, duke përcaktuar kategorinë e të pastrehëve që do të strehohen në to. Ky përcaktim është i detyrueshëm për organet e pushtetit lokal për efekt të shpërndarjes së këtyre banesave.

5. Listat e qytetarëve që kanë statusin e të përndjekurve politikë e që përfitojnë banesa falas, hartohen nga Komiteti i ish - të Përndjekurve Politikë dhe i dërgohen Entit Kombëtar të Banesave. Këto lista hartohen sipas dispozitave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.476, datë 10.10.1994 "Për procedurat e strehimit të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist".

6. Ministrinë dhe institucionet shtetërore buxhetore bëjnë kërkesë pranë Këshillit të Ministrave për plotësimin e nevojave të punonjësve të tyre të lartë, ushtarakëve dhe zyrtarëve të tjerë të transferuar. Këshilli i Ministrave miraton listën nominale dhe përcakton nëse banesat do të jepen me qira apo do të shiten për këta persona dhe, nëse do të shiten, si do të veprohet me banesat që ata kanë në pronësi.

Këshilli i Ministrave miraton gjithashtu listën e punonjësve në institucionet dhe ndërmarrjet buxhetore që do të trajtohen nga Enti Kombëtar i Banesave me shtesa anësore, shtesa kati etj. për plotësimin e nevojave të tyre për strehim sipas normativave dhe kriterëve të strehimit në fuqi.

Organet e pushtetit lokal dhe degët e Entit Kombëtar të Banesave, në bazë të listave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, kryejnë veprimet e nevojshme administrative dhe lidhin kontratat përkatëse sipas dispozitave në fuqi.

7. Këshilli i Ministrave përcakton fondet që ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore buxhetore do të përdorin për të ndërtuar banesa për punonjësit e tyre që kanë statusin e të pastrehëve ose që përfitojnë sipas pikës 6, paragrafët 1 dhe 2. Të gjitha llojet e fondeve që do të përdoren për ndërtimin e këtyre banesave, duhet t'ia kalojnë Entit Kombëtar të Banesave, i cili kryen ndërtimin e tyre sipas normativave shtetërore të strehimit në fuqi. Këto ndërmarrje e institucione hartojnë listat e punonjësve të pastrehë që do të strehohen dhe i depozitojnë pranë degëve të Entit Kombëtar të Banesave, i cili lidh kontratat e shitblerjes me qytetarët. Banesat që këto ndërmarrje dhe institucione buxhetore kanë në proces ndërtimi, do të ndahen vetëm për punonjësit e pastrehë në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

8. Trajtimi i qytetarëve të pastrehë sipas përcaktimeve të mësipërme do të bëhet sipas normativave shtetërore të strehimit në fuqi.

9. Enti Kombëtar i Banesave verifikon dokumentacionin, mbi bazën e të cilit janë hartuar

listat dhe në çdo rast shkeljeje të kritereve të caktuara refuzon lidhjen e kontratës së shitblerjes me qytetarin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi